

## **Çka është e drejta kushtetuese**

Emërtimi “E drejta kushtetuese” ka domethënie të dyfishtë. Ai përdoret për të shënuar një degë të vecantë të së drejtës positive të një vendi, sistem të caktuar normash juridike që kanë vlerë e rëndësi kushtetuese si dhe për të shënuar disiplinën shkencore e cila merret me studimin e sendërtimit të normave përkatsisht të së drejtës kushtetuese positive në praktikë.

E drejta kushtetuese si sistem normash me vlerë e rëndësi kushtetuese është paraqitur shumë herët, me paraqitjen e institucioneve themelore shtetërore dhe rregullave për funksionimin e tyre d.m.th me paraqitjen e shtetit.

Qysh në shtetet e para, si në Kinën e vjetër, Egjipt, shtetet e Afrikës Veriore, në territorin e Indisë së sotme dhe shtete tjera në Azi e sidomos në Grecinë antike dhe Romën e vjetër janë nxjerrë disa akte të shkruara me të cilat janë rregulluar çështje të rëndësishme shoqërore e politike siq janë: prona, klasat, mardhëniet ekonomike, institucionet e pushtetit, të drejtat dhe privilegjet e shtresave të caktuara të popullsisë, të bartësve të pushtetit etj.

Aktet e këtilla sidomos CONSTITUTIO në Romën e vjetër paraqesin bazën dhe elementet e para të së drejtës kushtetuese.

Rëndësi të vecantë në këtë drejtim kanë edhe Magna Charta Libertatum (1215) si dhe aktet tjera në formë të deklaratave, kodeve, edikteve etj. Të gjitha këto të nxjerra gjatë nga shek.XIII deri në shek.XVIII.

E drejta kushtetuese si shkencë. Është disiplinë shkencore e cila merret me studimin e së drejtës kushtetuese si degë e së drejtës, përkatsisht merret me sqarimin dhe interpretimin e normave të cilat rregullojnë materien kushtetuese, me formulimin e institutive juridike të cilat i zbaton në degët e së drejtës si tërësi koherente pastaj në mënyrë kritike nga aspektet e filozofizë juridike i vleron normat kushtetuese, studion funksionimin e sistemit kushtetues dhe efektin e tij në praktikë etj.

E drejta kushtetuese si shkencë politiko-juridike. Karakteri i saj si shkencë politike qëndron në faktin se numri më i madh i normave juridike, me të cilat bëhet rregullimi i materies kushtetuese kanë të bëjnë me pushtetin politik, përkatsisht me formimin dhe organizimin e organeve shtetërore, autorizimet e tyre etj. Tërë pushtetin shtetërorë, institucionet dhe fenomenet politike i studion nga aspekti politikologjik.

### **Kuptimi i së drejtës kushtetuese**

Kuptimi i se drejtes kushtetuese Kuptimi pozitiv-juridik (nenkupton sistemin e normave juridike te kodifikuara ne nje dokument-kushtetute).

Kuptimi materialist, apo sociologjiko-politik (nenkupton te drejten ekzistuese qe materializohet ne jeten e nje vendi)

Kuptimi teorik apo shkencor (qe mesohet ne universitete) Kuptimi me i plote eshte ai qe gersheton kuptimin e pare dhe te dYTE

### **cili esht objekt i studimit t; se drejtes kushtetuese**

Objekti i se drejtes kushtetuese Objekti i se drejtes kushtetuese ne nje vend eshte i kushtezuar nga perbajtja e saj. Mbizotron menyra juridike-dogmatike e percaktimit te objektit: eshte teksti i kushtetutes, ne SHBA objekt jane normat e Kushtetutes se SHBA-ve 1787 dhe amendamentet

kushtetuese ne fuqi si dhe vendimet e gjykatave nepermjet te cilave interpretohen normat kushtetuese Ne Angli jane normat e shkruara dhe doket (konvencionet) me te cilat rregullohet materia kushtetuese Ne france pervec normave kushtetuese objekt jane edhe Institucionet politike.

Ne pergjithesi objekt jane: Raportet themelore politike (forma e qeverisjes, dhe menyra e ushtrimit te pushtetit ne shoqeri, karakteri i regjimit politik, organizimi, autorizimet dhe raporti midis organeve qendrore te pushtetit, procesi zgjedhor i organeve te pushtetit legjislativ, gjyqesor e te kontrollit si dhe pozita e njeriut ne sistemin e pushtetit, shteti ligjor apo totalitar Vlerat juridike (rendi, qetesia, liria, siguria, dinjiteti i njeriut, drejtesia , e verteta, etj) me te cilat percaktohet perbajtja konkrete e atyre raporteve, si dhe Normat juridike me te cilat rregullohen raportet themelore politike qe kane te bejne me pushtetin dhe poziten e njeriut ne shoqeri (te shkruara dhe jo te shkruara)

### **Cilat janë metodat e së drejtës kushtetuese**

Metodat e se drejtes kushtetuese Metoda dogmatike – pasqyrohet dhe zbulohet perbajtja e normave juridike me te cilat rregullohen raportet politike themelore dhe institucionet politike ne nje vend vetem ashtu siq jane te formuluar ndaras nga zbatimi i tyre ne praktike

Metoda politikologjike – studjon zbatimin konkret te normave kushtetuese ne praktike ku nxirren perfundime lidhur me qendrueshmerin e normave kushtetuese dhe nevojën e ndryshimit apo plotesimit te tyre

Metoda aksiologjike – studjon vlerat juridike: rendi, qetesia, liria, siguria, dinjiteti i njeriut, drejtesia, e verteta, etj

### **Cilat jan vetit e kushtetutes**

#### **Vetitë e kushtetutës**

1) Së pari – Kushtetuta është ligji themelor i një vendi. Me kushtetutë caktohet organi dhe rregullohet procedura e nxjerrjes së ligjeve. Ajo përmban rregulla juridike më të përgjithsuara se ato që përmbajnë ligjet dhe rregullon materie më të gjërë nga ajo që rregullohet me ligje. Dispozitat e saj kanë fuqi më të lartë juridike në raport me dispozitat ligjore. Është ligj mbi ligjet.

2) Së dyti – kushtetuta ka vetinë e aktit më të lartë juridik. Nga kushtetuta buron dhe mbështetet i tërë rendi juridik i vendit. Fuqinë e saj juridike më të lartë e përcakton vet organi kushtetues nëpërmjet kushtetutës.

3) Së treti – kushtetuta ka edhe vetinë e aktit ideo-politik. Ajo është bazë jo vetëm për rregullimin por edhe ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore në një vend.

4) Së katerti – kushtetuta shquhet edhe si akt programor-deklarativ.

Vetite e kushtetutes Eshte ligj themelor i nje vendi (nepermjet saj caktohet organi dhe procedura e nxjerrjes se ligjeve, perban rregulla me te pergjithesuara se ato qe perbajne ligjet dhe rregullon materie me te gjere se ato qe rregullojne ligjet) Eshte akt me i larte juridik (kete ia siguron kualiteti i organit qe e miraton, procedura e vecant per miratimin dhe ndryshimin e saj si dhe perbajtja e ceshtjeve qe rregullon Eshte akt ideo-politik (vjen ne shprehje ideologjia e caktuar zoteruese me rastin e miratimit. Disa dispozita sidomos ne hyrje kane perbajtje te hapte ose te fshehte politike, ngase me ato rregullohen marredheniet temelore politike ne vend) Eshte akt programor deklarativ (percakton suazat e

zhvillimit të rregullimit shoqërorë e shtetëror, qëllimet dhe detyrat e rendit kushtetues, përbanë dispozita për zbatimin e të cilave duhet nxjerr ligje)

### **Çka kuptojmë me kushtetutat e buta**

Teoria mbi kushtetutat e forta (ngurta) dhe të buta (flexibile)

Mbështetet në kuptimin e kushtetutës në elemente procedurale. Autor i saj ishte Xhejms

Brajsi. Faktorët që ndikojnë që një kushtetutë të jetë e fortë ose e butë janë:

- Ograni i cili e miraton kushtetutën apo ndryshimin e saj
- Procedura për ndryshimin ose miratimin e saj
- Shumica e votave për miratimin e kushtetutës apo ndryshimin e saj

### **Çështje preambula**

Preambula (lat.preambulum – hyrje, parahyrje, parathënie)

Gjendet në fillim të kushtetutës dhe është e ndarë nga pjesa normative e saj. Ka rasta kur preambula futet në kushtetutë në formë të parimeve themelore apo deklaracion mbi parimet e sistemit të proklamuar.

Preambula zakonisht është e shkurtër dhe koncize. Ajo shpreh bazën ideore dhe qëllimet e hartimit të kushtetutës. Për dallim nga pjesa normative ajo është tërësi kontinuele dhe nuk është e ndarë në nene. Ajo nuk ka efekt juridik. Preambula praktikohet në kushtetutat e miratuara pas revolucioneve, pas luftërave nacional-clirimtare. Preambulën e hasim qysh në kushtetutën e SHBA-ve 1787 por edhe në kushtetutën e Kosovës si vend i tranzicionit 1990.